




KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.  
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.  
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.



Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen me nenin 21, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Ligji nr.03/L-087, dt.13.06.2008, dhe nenit 13 të Ligjin nr.04/L-111 dt. 20.04.2012 për ndryshimin dhe plotësimi e Ligjit për Ndërmarrjet Publike Ligji nr.03/L-087 me tej në tekst: (Ligji nr.03/L-087), Rregulloreve të Reja të KEK (miratuar 09 dhjetor 2009), si dhe Vendimit të Bordit të Drejtorëve dt. 27 Shkurt 2025, Bordi i Drejtorëve të KEK Sh.A, shpall:

## KONKURS PUBLIK

Titulli i punës: **KRYESHEF EKZEKUTIV**  
Vendi: Prishtinë  
Ndërmarrja: Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A.  
Mandati: Katër (4) vite  
Orari: Plotë  
Paga: Konkurruese

Afati i fundit për aplikim: **03 Prill 2025 (e enjte), ora 16:00**

### PËRSHKRIM I NDËRMARRJES

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh.A.) është Ndërmarrje Publike e cila në strukturën e saj përfshinë minierat e thëngjillit, njësitë gjeneruese të TC A dhe B, financat dhe kontabilitetin, shërbimet e korporatës dhe Auditimin e Brendshëm. KEK Sh.A. aktualisht realizon të hyra vjetore mbi € 200 milion.

### TITULLI I PUNËS: KRYESHEF EKZEKUTIV

Kryeshefi Ekzekutiv (KE), duke i raportuar Bordit të Drejtorëve, drejton të gjitha aktivitetet e KEK Sh.A. duke koordinuar dhe mbikëqyrë drejtpërsëdrejti punën e menaxherëve ekzekutiv të divizioneve dhe shërbimeve të përbashkëta të KEK Sh.A.

**Në veçanti, Kryeshefi Ekzekutiv duhet të kujdeset për:**

- Zhvillimin strategjik të KEK Sh.A. dhe udhëheqjen e Korporatës përmes ndryshimeve cilësore dhe me rëndësi esenciale për suksesin e biznesit.
- Transformimin e KEK Sh.A. në një ndërmarrje energjetike moderne me afarizëm komercial të vetë qëndrueshëm dhe me orientim drejtë një furnizimi të qëndrueshëm me energji për ekonominë e vendit.
- Orientimin e Korporatës drejtë zhvillimit, rritjes dhe fuqizimit të kapaciteteve të reja të energjisë së ripërtëritshme dhe tranzicionit të KEK Sh.A.
- Optimizimin e proceseve afariste në tërë korporatën duke përfshirë ristrukturimin, numrin optimal të punëtorëve në pajtim me standardet ndërkombëtare për korporata të këtij lloji.

**KE ka përgjegjësi të plotë për:**

- Operacionet ditore të KEK Sh.A. si tërësi.
- Realizimin e Bilancit Energjetik Vjetor të aprovuar.
- Zhvillimin dhe mirëmbajtjen e mihjeve.
- Menaxhim kualitativ të kapaciteteve gjeneruese të energjisë.
- Planifikimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve infrastrukturore fizike të Korporatës.

- Zhvillimin dhe implementimin e përpiktë të programit dhe praktikave më të mira të qeverisjes korporative për përmirësimin e performancës financiare.
- Përbushjen e detyrimeve që burojnë nga traktatet ndërkombëtare, ligjet e Kosovës, licencat e operimeve dhe aktet tjera të ZRrE-së dhe KPMM-së.
- Zbatimin e vendimeve të Bordit të Drejtorëve të Korporatës.
- Përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Planeve Vjetore të Biznesit të Korporatës, përfshirë administrimin e buxheteve vjetore për operime, mirëmbajtje, shpenzime, paga dhe investime kapitale.
- Sigurimin e mbarëvajtjes së proceseve të prokurimit dhe transaksioneve financiare.
- Planifikimin dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore të Korporatës.
- Shqyrtimin vjetor të performancës dhe të masave për motivim në punë.
- Siguron vendosjen e sistemit të kontrollit të brendshëm operacional dhe financiar, menaxhimin e informacionit duke i mundësuar Korporatës të ekzekutoj aktivitetet e saj në mënyrë të ligjshme dhe etike.
- Përfaqësimin e Korporatës brenda dhe jashtë vendit.
- Pjesëmarrje aktive në cilësi të Anëtarit të Bordit (ex -officio) në të gjitha takimet e Bordit të Drejtorëve të Korporatës.
- Kryen edhe punë tjera të përcaktuar me ligjet e zbatueshme, Statutin dhe akteve tjera të brendshme të Korporatës

#### **KE duhet të ketë:**

- Aftësi për udhëheqje për arritjen e objektivave të përgjithshme të KEK Sh.A., si dhe aftësi për të marrë vendime të rëndësishme në situata të vështira.
- Aftësi për implementimin e ndryshimeve të nevojshme dhe aplikimin e metodave të reja afariste për përballimin e sfidave të reja.
- Aftësi për komunikim efikas me shkrim dhe me gojë me Bordin e Drejtorëve, me ndërvlerësuesit e vet, me konsumatorët, me palët e interesuara, me zyrtarët qeveritar, me media, si dhe me palët tjera me interes.
- Zotësi për t'u përshtatë situatave të pa-planifikuara, apo të ndryshme dhe fleksibilitet në përballje me rrethana të tilla.
- Zotësi të delegimit të autoritetit dhe rritjes së përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara.
- Vendosmëri në zbatimin e masave disiplinore për drejtuesit dhe punonjës në përputhje me aktet e brendshme dhe legjislacionin në fuqi.
- Integritet të lartë moral dhe t'i përmbahet standardeve të larta të etikes.

Performanca e Zyrtarit të Lartë do t'i nënshtrohet vlerësimit të vazhdueshëm nga Bordi i Drejtorëve.

## **Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**

### **Kandidati duhet të ketë:**

- Diplomë universitare në lëmin e administrimit të biznesit, ekonomisë, financave, inxhinierisë apo juridik (së paku 180 kredi/ECTS), e preferueshme niveli i studimeve post-diplomike (master).
- Së paku 5 vite përvojë në nivel të lartë menaxherial, preferohet në kompani nga sektori i energjisë.
- Preferohen njohuri të mira të gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur.

Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 21 paragrafi 4, lidhur me nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë, kërkesa këto sipas Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike nr. 04/L-111 (referuar nenit 13 të këtij ligji).

Kushtet e kualifikimit referuar pikës së lartcekur janë të detajuara në Deklaratën nën betim e cila do të pranohet dhe nënshkruhet nga kandidatet.

### **Në fazën e dorëzimit të aplikimit, të gjithë kandidatët duhet të dorëzojnë:**

1. Formulari i Aplikimit të KEK-ut (mund ta shkarkoni në [www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com)).
2. Një Curriculum Vitae - CV (jo më shumë se 4 faqe).
3. Letër motivuese (të elaborohet ndërlidhja e përvojës dhe/ose kualifikimit tuaj me pozitën e synuar).
4. Një kopje e ID ose Pasaportës (valide).
5. Dëshmi mbi përvojën e punës menaxheriale nga punëdhënësi (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe trusti pensional).
6. Kopja e diplomës së studimeve dhe kopjet e certifikatave të kualifikimit (përfshirë edhe kopjen e vendimit të nostrifikimit të diplomës nëse kandidati/ja ka përfunduar studimet jashtë Kosovës).
7. Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 gjashtë muaj nga data e lëshimit).
8. Deklarata nën betim e nënshkruar (mund ta shkarkoni në [www.kek-energy.com](http://www.kek-energy.com)). Deklarata e panënshkruar do të rezultojë me eliminim nga gara.

Aplikuesi duhet ta plotësojë personalisht deklaratën nën betim, në të cilën deklaron se ai/ajo i plotëson kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgënjeshttrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratë do të rezultojë në diskualifikim të menjëhershëm.

Kandidatët me dokumentacion të mangët, të pa plotësuar dhe jo adekuat do të refuzohen. Po ashtu, dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë për mbylljen e konkursit publik nuk pranohen.

Të gjithë dokumentet e kërkuara për aplikim sipas kërkesë së lartcekur (1 deri 8) duhet të dorëzohen në formë elektronike, vetëm në formatin (pdf).

Vetëm kandidatët e përzgjedhur që i plotësojnë kushtet do të ftohen në intervistë.

Kandidati i përzgjedhur si i suksesshëm para nënshkrimit të kontratës për themelimin të marrëdhënies së punës duhet t'i sjell dokumentet origjinale ose kopjet e noterizuara, përfshirë edhe vendimin e nostrifikimit të diplomës nëse kandidati/ja ka përfunduar studimet jashtë Kosovës.

**Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është 03.04.2025 (e enjte), ora 16:00. Aplikimet duhet të dërgohen me e-mail në: [kek.bord@kek-energy.com](mailto:kek.bord@kek-energy.com), duke e vendosur titullin në subjekt si më poshtë:**

***Aplikimi për Kryeshef Ekzekutiv***

